



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
MINISTRI

Nr. 4048 Prot.

Tiranë, më 11.10.2012

U D H Ë Z I M

Nr. 12. Datë 11.10.2012

PËR

ZHVILLIMIN E KONKURSEVE TË PRANIMIT, TARIFËN E REGJISTRIMIT PËR
KONKURRIM NË DISA PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË PARË ME KOHË TË
PLOTË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË,
NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË,
VITI AKADEMIK 2012 - 2013

Mbështetur në Nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si edhe në Nenin 33 dhe 75 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05. 2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimi nr 420, datë 27.06.2012 të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si edhe tarifatat e shkollimit për vitin akademik 2012 - 2013", si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006 "Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pranimet në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2012-2013, në:
 - 1.1. Universitetin e Arteve të Tiranës (të gjitha programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë),
 - 1.2. Akademinë e Arteve Shkodër (të gjitha programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë),
 - 1.3. Universitetin e Sporteve të Tiranës (të gjitha programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë),
 - 1.4. Universitetin Politeknik të Tiranës (programet e integruara të studimit të ciklit të dytë "Arkitekturë" dhe "Arkitekturë-Urbanist"),
 - 1.5. Universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër, (programi i studimit të ciklit të parë me kohë të plotë "Edukim Fizik dhe Sporte"),
 - 1.6. Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan (programi i studimit të ciklit të parë me kohë të plotë "Edukim Fizik dhe Sporte"),

1.7. Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës (programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë, të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën FASTIP),

të bëhen mbi bazën e rezultateve të Maturës Shtetërore dhe të rezultateve të fituara nga konkursi i pranimit, i organizuar nga këto Institucione Publike të Arsimit të Lartë.

2. Në Universitetin e Arteve të Tiranës dhe në Akademinë e Arteve në Shkodër, rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore), të llogariten në masën 30% dhe rezultatet e konkursit të pranimit në masën 70%, sipas Tabelës nr. 1, bashkëngjitur këtij Udhëzimi. Konkurrimi për kandidatët e Akademisë së Arteve të Shkodrës do të kryhet në bashkëpunim me Universitetin e Arteve të Tiranës, në ambientet e këtij të fundit.

Kandidati që nuk kalon pragun e pikëve minimale të konkursit të pranimit, në programin ku ka konkurruar, sipas Tabelës nr. 2, bashkëngjitur këtij Udhëzimi, sipas përcaktimit për program studimi, nuk fiton të drejtën e studimit.

3. Në Universitetin e Sporteve të Tiranës rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e të shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore), të llogariten në masën 50%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit në masën 50%, sipas Tabelës nr. 1, bashkëngjitur këtij Udhëzimi.

4. Në Universitetin Politeknik të Tiranës, në programet e studimit "Arkitekturë" dhe "Arkitekturë-Urbanist" rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore), të llogariten në masën 40%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit në masën 60%, sipas Tabelës nr. 1, bashkëngjitur këtij Udhëzimi.

5. Në Universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër dhe Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, në programin e studimit "Edukim Fizik dhe Sporte" të rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore), të llogariten në masën 50%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit në masën 50%, sipas Tabelës nr. 1, bashkëngjitur këtij Udhëzimi.

6. Në programet e studimit të FASTIP të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore), të llogariten në masën 40%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit (Gjuha Angleze dhe intervista e punësimit) në masën 60%, sipas Tabelës nr. 1, bashkëngjitur këtij Udhëzimi.

7. Për të gjitha programet e studimit, sipas pikës 1, të këtij Udhëzimi, pikët minimale dhe maksimale të konkurseve përcaktohen në Tabelën nr. 2, bashkëngjitur këtij Udhëzimi.

8. Rregulloret dhe programet e konkurseve, të miratuara nga IAL Publike përkatëse, të bëhen publike, duke filluar nga data 1 Gusht 2012.

9. Kandidatët që kanë kërkuar në Formularin A2, programet e studimit sipas pikës 1, të këtij Udhëzimi, si edhe kandidatët shqiptarë që do të marrin pjesë në konkurset e pranimit për këto programe studimi nga Republika e Kosovës, nga Republika e Maqedonisë, nga Republika e Malit të Zi dhe nga Lugina e Preshevës të regjistrohen për zhvillimin e konkursit pranë sekretarive mësimore të Fakultetit përkatës. Periudha e regjistrimit të jetë nga data 16 Gusht 2012 deri në orën 12.00 të datës 27 Gusht 2012.
10. Agjencia Kombëtare e Provimeve AKP, deri në datën 14 Gusht 2012, të përgatisë listën e konkurrentëve për konkurset e pranimit në programet e studimit sipas pikës 1, të këtij Udhëzimi, sipas preferencës së kërkuar prej tyre në Formularin A2.
11. Listat e konkurrentëve për secilin konkurs pranimi, të pikës 1, në formë të shkruar dhe elektronike, t'u dorëzohen Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë, sipas programit të studimit, në datën 15 Gusht 2012, nga AKP për të gjithë kandidatët që kanë plotësuar Formularin A2 dhe nga MASH-i për kandidatët shqiptarë që do të marrin pjesë në konkurset e pranimit për këto programe studimi nga Republika e Kosovës, nga Republika e Maqedonisë, nga Republika e Malit të Zi dhe nga Lugina e Preshevës.
12. Rektoratet dhe dekanatet e IAL Publike të shpallin në mjedise të dukshme të institucioneve të tyre deri në datë 10 Gusht 2012: datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për të siguruar një ecuri normale të procesit të regjistrimeve në konkursin e pranimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë.
13. Sekretaritet mësimore të fakulteteve përkatëse, të programeve të studimit të pikës 1 dhe 2, pas verifikimit të listave të të regjistruarve, me listën e dorëzuar nga AKP dhe nga MASH, në datën 17 Gusht 2012, ora 12.00, të shpallin listat e konkurrentëve të regjistruar dhe t'i afishojnë ato në vende të dukshme, në mjediset e Fakulteteve të tyre.
14. Datat e konkursit të pranimit në këto Institucione Publike të Arsimit të Lartë, të jenë sipas këtij kalendari :
 - 16.1 Universiteti i Arteve, Tiranë, për të gjitha programet e studimit në:

a. Fakultetin e Muzikës	27 Gusht – 1 Shtator 2012
b. Fakultetin e Artit Skenik	27 Gusht – 1 Shtator 2012
c. Fakultetin e Arteve Figurative	27 Gusht – 1 Shtator 2012
 - 16.2 Universiteti i Sporteve të Tiranës, për programet e studimit:

a. Shkenca të Lëvizjes	29-31 Gusht 2012
b. Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit	29-31 Gusht 2012

- 16.3 Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, për programin e studimit:
- a. Edukim Fizik dhe Sporte 27-29 Gusht 2012
- 16.4 Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, për programin e studimit:
- a. Edukim Fizik dhe Sporte 27-29 Gusht 2012
- 16.5 Universiteti Politeknik i Tiranës, për programet e studimit:
- a. Arkitekturë 03-05 Shtator 2012
 - b. Arkitekturë (Urbanist) 03-05 Shtator 2012
- 16.6 Universiteti "A. Moisiu" i Durrësit (FASTIP), për programet e studimit (Programe në Gjuhë Angleze):
- a. Menaxhim i Bankave 27-29 Gusht 2012
 - b. Menaxhim Hoteleri Turizëm 27-29 Gusht 2012
 - c. Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme 27-29 Gusht 2012
 - d. Multimedia dhe Teknologji Informacioni 27-29 Gusht 2012
- 16.7 Akademia e Arteve, Shkodër, për të gjitha programet e studimit në:
- a. Fakultetin e Muzikës 27 Gusht – 1 Shtator 2012
 - b. Fakultetin e Arteve Figurative 27 Gusht – 1 Shtator 2012
15. Tarifat e regjistrimit të kandidatëve pjesëmarrës në konkurset e pranimit në këto Institucione Publike të Arsimit të Lartë, të jenë si më poshtë :
- a. Në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Sporteve të Tiranës: 5,000 (pesë mijë) lekë.
 - b. Në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Arteve, Tiranë: 5,000 (pesë mijë) lekë.
 - c. Në programet e studimit në Universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër: "Edukim fizik dhe sporte" 5,000 (pesë mijë) lekë, dhe "Pikturë-Grafikë" 5,000 (shtatë mijë) lekë.
 - d. Në programin e studimit "Edukim Fizik dhe Sporte" në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan: 4,000 (katër mijë) lekë.
 - e. Në programin e studimit "Arkitekturë" dhe "Arkitekturë-Urbanist" në Universitetin Politeknik të Tiranës: 8,000 (tetë mijë) lekë.
 - f. Në të gjitha programet e studimit në Akademinë e Arteve, Shkodër: 5,000 (pesë mijë) lekë.
16. Të gjitha tarifat e regjistrimit për konkurrim në programet e ndryshme të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë të arkëtohen nëpërmjet sistemit bankar ose zyrove të postës shqiptare, për llogari të IAL-së Publike përkatëse.

17. Konkursët e pranimit në këto Institucione Publike të Arsimit të Lartë të monitorohen nga përfaqësues të MASH-it.
18. Rezultatet e konkurseve të pranimit të dërgohen në MASH e në AKP, në letër dhe CD, brenda 3 ditëve nga përfundimi i tyre. Për konkurrentët nga Republika e Kosovës, vetë IAL Publike përkatëse, të shpallin kandidatët fitues, sipas kuotave të miratuara për çdo program studimi.
19. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe e Kërkimit Shkencor, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) dhe Institucionet Publike përkatëse të Arsimit të Lartë.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

MYQEREM TAFAJ



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS (TABELA NR. 1)
PËRQINDJET QË ZËNË MATURA SHTETËRORE DHE KONKURSI NË PIKËT FINALE TË MERITË-PREFERENËS

EMERTIMI I UNIVERSITETIT	EMRTIMI I FAKULTETIT	ID_PROGRAMIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	% Maturës Shtetërore	% Konkursit të Pranimit
Univ. Politeknik i Tiranës	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	074	Arkitekturë (Arkitekt)	40	60
Univ. Politeknik i Tiranës	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	075	Arkitekturë (Urbanist)	40	60
Univ "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	141	Edukim Fizik dhe Sporte	50	50
Univ "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	181	Edukim Fizik dhe Sporte	50	50
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)	264	Menaxhim i Bankave (Program në Gjuhë Angleze)	40	60
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)	265	Menaxhim Hoteleri Turizëm (Program në Gjuhë Angleze)	40	60
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)	266	Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (Program në Gjuhë Angleze)	40	60
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)	267	Multimedia dhe Teknologji Informacioni (Program në Gjuhë Angleze)	40	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	268	Regji Filmi dhe TV	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	269	Aktrim	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	270	Regji	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	271	Skenografi - Kostumografi	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	272	Koreografi	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Figurativ	273	Pikturë	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Figurativ	274	Skulpturë	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	275	Muzikologji	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	276	Kompozim	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	277	Dirizhim	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	278	Piano	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	279	Violinë	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	280	Violonçel	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	281	Violë	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	282	Kitarë	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	283	Kontrabas	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	284	Flaut	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	285	Oboe	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	286	Klarinetë	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	287	Fagot	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	288	Korno	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	289	Trombë	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	290	Trombonë	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	291	Bastub	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	292	Kanto	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	293	Pedagogji Muzikore	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	294	Fizarmonikë Klasike	30	70
Univ. i Sporteve Tiranë	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	295	Shkencat e Lëvizjes	50	50
Univ. i Sporteve Tiranë	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	296	Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit	50	50
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	297	Violinë	30	70
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	298	Piano	30	70
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	299	Kanto	30	70
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	300	Kompozim	30	70
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	301	Dirigjim	30	70
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Artit Figurativ	302	Pikturë	30	70
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Artit Figurativ	303	Pikturë - Grafikë	30	70



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS (TABELA NR. 2)
PIKËT MAKSIMALE DHE MINIMALE SIPAS PROGRAMEVE NË KONKURSET E PRANIMIT

EMERTIMI I UNIVERSITETIT	EMERTIMI I FAKULTETIT	ID_PROGRAMIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Pikët Maksimale	Pikët Minimale
Univ. Politeknik i Tiranës	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	074	Arkitekturë (Arkitekt)	70	0
Univ. Politeknik i Tiranës	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	075	Arkitekturë (Urbanist)	70	0
Univ "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	141	Edukim Fizik dhe Sporte	70	0
Univ "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	181	Edukim Fizik dhe Sporte	70	0
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)	264	Menaxhim i Bankave (Program në Gjuhë Angleze)	100	40
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)	265	Menaxhim Hoteleri Turizëm (Program në Gjuhë Angleze)	100	40
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)	266	Menaxhim i Ndërmartjeve të Vogla dhe të Mesme (Program në Gjuhë Angleze)	100	40
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)	267	Multimedia dhe Teknologji Informacioni (Program në Gjuhë Angleze)	100	40
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	268	Regji Filmi dhe TV	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	269	Aktrim	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	270	Regji	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	271	Skenografi - Kostumografi	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	272	Koreografi	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Figurativ	273	Pikturë	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Figurativ	274	Skulpturë	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	275	Muzikologji	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	276	Kompozim	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	277	Dirizhim	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	278	Piano	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	279	Violinë	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	280	Violonçel	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	281	Violë	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	282	Kitarë	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	283	Kontrabas	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	284	Flaut	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	285	Oboe	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	286	Klarinetë	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	287	Fagot	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	288	Korno	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	289	Trombë	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	290	Trombonë	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	291	Bastub	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	292	Kanto	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	293	Pedagogji Muzikore	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	294	Fizarmonikë Klasike	240	60
Univ. i Sporteve Tiranë	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	295	Shkencat e Lëvizjes	70	0
Univ. i Sporteve Tiranë	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	296	Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit	70	0
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	297	Violinë	240	60
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	298	Piano	240	60
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	299	Kanto	240	60
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	300	Kompozim	240	60
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	301	Dirigjim	240	60
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Artit Figurativ	302	Pikturë	240	60
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Artit Figurativ	303	Pikturë - Grafikë	240	60

